

DETYRE PROJEKTIMI

Studim Projektim:"Ndërtim i rrjetit (K.U.N) në lagjen "Baba Rexhepi", Rr."Idriz Alidhima, Lidhja e kolektorit të bulevardit të ri në rr. "Jonianet" dhe zëvendesimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit (Pipe Bursting)",Sarandë."

OBJEKTI: Projektimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura(KUN) në objektin e kontratës:

Studim Projektim:"Ndërtim i rrjetit (K.U.N) në lagjen "Baba Rexhepi", Rr."Idriz Alidhima, Lidhja e kolektorit të bulevardit të ri në rr. "Jonianet" dhe zëvendesimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit (Pipe Bursting)",Sarandë."

VENDODHJA: Zonat e ndërhyrjeve ku shtrihet objekti i kontratës “Studim Projektim:"Ndërtim i rrjetit (K.U.N) në lagjen "Baba Rexhepi", Rr."Idriz Alidhima, Lidhja e kolektorit të bulevardit të ri në rr. "Jonianet" dhe zëvendesimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit (Pipe Bursting)",Sarandë" shtrihen përkatësisht:

Lagje “Baba Rexhepi” në pjesën veri-perëndimore të qytetit të Sarandës, Rruga “Idriz Alidhima”, ne pjesen perendimore të qytetit te Sarandës dhe Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të ri në Rrugën “Jonianët”, në pjesën perëndimore të qytetit të Sarandës;

Zëvendësimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit të ujërave të zeza", shtrihen përgjate një segmenti të rrugës "Butrinti", pranë vijës bregdetare

OËLLIMI: Përmirësimi i kushteve higjienosanitare dhe të jetesës së banorëve dhe objekteve të ndryshme social kulturore e turistike si dhe mjedisit në zonat e lartpërmendura të qytetit të Sarandës. Kthimi ne funksion normal i punes se Stacionit Kryesor të Pompimit të Ujërave të Zeza të qytetit të Sarandës.

1 – TË DHËNAT KRYESORE

Fondi limit llogaritur sipas Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016: "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudimpër "Studim-Projektim i Rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura (K.U.N) në Lagjen "Baba Rexhepi", Rruga "Idriz Alidhima", Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të Ri në Rrugën "Jonianët" dhe Zëvendësim i Tubit të Dërgimit të Stacionit Kryesor të Pompimit të Ujërave të Zeza (Pipe bursting)", me vendndodhje në Sarandë është 18,620,171 lekë pa T.V.Sh.

2 – PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJENDJES

Zona në studim shtrihet në një pjesë të konsiderueshme të qytetit të Sarandës, dhe ndahet në 2 zona. Zonat që do të trajtohen përbëhen nga Lagje "Baba Rexhepi", Rruga "Idriz Alidhima", Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të Ri në Rrugën "Jonianët" dhe zëvendësimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit të ujërave të zeza (Pipe bursting) i shtrire përgjate një segmenti të rrugës "Butrinti".

- I. Zona 1 është e pozicionuar në pjesen veri-perendimore të qytetit bregdetar të Sarandës dhe përfshin lagjen "Baba Rexhepi" me një sipërfaqe afersisht 70 ha, përfshi ndertimin e kolektorit te ri kryesor pergjate rrugës "Idriz Alidhima" (perfshi lidhjet e rrjeteve ekzistuese ne kolektorin e ri) dhe Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të Ri në Rrugën "Jonianët".

- II. Zona 2 shtrihet në një pjesë të konsiderueshme të rrugës “Butrinti” në qytetin e Sarandës, dhe fillon tek stacioni kryesor i ujërave të zeza, pranë bulevardit “Naim Frashëri”, vazhdon përgjatë rrugës “Butrinti” dhe mbaron pranë resortit “Santa Quaranta”.

Në Zonen 1 nuk ka gjurmë të rrjeteve inxhinierike (ujërat sipërfaqesore lëvizin nëpër trupin e rrugeve ekzistuese dhe ujërat e zeza pergjithesisht jane te trajtuara me gropa septike individuale). Për këtë arsye në këto zona duhet të parashikohet për studim-projektim, rehabilitim i ujërave të ndotura (KUZ) përfshi ndertimin e kolektorit te ri kryesor pergjate rrugës “Idriz Alidhima” (perfshi lidhjet e rrjeteve ekzistuese ne kolektorin e ri) dhe Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të Ri në Rrugën “Jonianët”, si dhe ndërhyrjet për trajtim të shtresave rrugore nëpër të cilat do të shtrihen kolektorët për grumbullimin dhe përcjelljen e ujërave të ndotura.

Zona 2 perfshin linjen e dergimit te stacionit kryesor te pompimit te qytetit te Sarandes, e cila perbehet nga tub PVC Dn300mm, tejet i amortizuar dhe me demtime ne te gjithe gjatesine e tij. Per riparimet e tij nga ana e grupeve te mirembajtjes behen 4-5 ndrhyrje ne vit (kryesisht ne periudhen e veres kur prurjet e pompuara nga ky stacion jane edhe me te medha). Nderhyrjet riparuese behen zakonisht me fasheta gome nga jashte tubit PVC, pra nderhyrje per te zgjidhur emergjencen, me jetgjatesi te shkurter e funksionalitet te cenuar. Kjo linje shtrihet në një pjesë të konsiderueshme të rrugës “Butrinti” në qytetin e Sarandës, dhe fillon tek stacioni kryesor i ujërave të zeza, pranë bulevardit “Naim Frashëri”, vazhdon përgjatë rrugës “Butrinti” dhe derdhet pranë resortit “Santa Quaranta”.

Karakteristika te përgjithëshme për segmentët të cilat duhet të konsiderohen për studim-projektim të KUN janë të përshkruara në paragrafët si më poshtë vijon:




Figura 1. Zona I lagje “Baba Rexhepi”, ndertimi i kolektorit te ri kryesor pergjate rrugës “Idriz Alidhima” (perfshi lidhjet e rrjeteve ekzistuese ne kolektorin e ri) dhe Lidhja e Kolektorit të Bulevardit të Ri në Rrugën “Jonianët”




Figura 2. Zona 2 linja e dergimit te stacionit kryesor te pompimit te qytetit te Sarandes shtrihet ne rrugen "Butrinti" ne qytetin e Sarandes.

Duke qenë se ky aks është mjaft jetik për të gjithë zonën turistike të qytetit të Sarandës kërkohet që tubi ekzistues të zëvendësohet nëpërmjet teknologjisë (Pipe bursting), nëpërmjet të cilës garantohet kohë mjaft e shkurtër realizimi pa kryer punime gërmimi në të gjithë gjatësinë e shtrirjes së kësaj linje. Në mënyrë që stacioni i pompimit të punojë edhe gjatë kohës së zëvendësimit të linjës ekzistuese duhet të parashikohet sistem by-passi.

3 – OBJEKTIVI

Objektivi i detyrës së projektimit është hartimi i projekteve të zbatimit për:

“Studim Projektim: "Ndërtim i rrjetit (K.U.N) në lagjen "Baba Rexhepi", Rr."Idriz Alidhima, Lidhja e kolektorit të bulevardit të ri në rr. "Jonianet" dhe zëvendësimi i tubit të dërgimit të stacionit kryesor të pompimit (Pipe Bursting)", Sarandë."

4 – OËLLIMI I PUNËS .

Është hartimi i projektit sipas kushteve teknike të projektimit dhe standardeve të kërkuara sipas kësaj detyre projektimi. Për realizimin e projekteve të zbatimit projektuesit duhet të rishikojnë të gjithë informacionin ekzistues të konsultohet me Drejtorinë e Planifikimit të Investimeve të Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A, OSHE, Telekomin, etj. Pra mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A përpara fillimit të punës për projektimin e objekteve, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe kjo si për garantimin e saktësisë të bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme.

Cilësia e Studim – Projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standardi i kërkuar dhe të plotësojë kushtet teknike të projektimit.

5 – TË DHËNAT PËR PROJEKTIN

- Perspektiva e rrjetit të kanalizimeve të parashikohet për 25 vjet.
- Të merret në konsideratë perspektiva 25 vjeçare e rritjes së popullsisë.
- Shtesa natyrore e popullsisë të merret 2.5 %.
- Të merret në konsideratë planimetria e rrjetit ekzistues.
- Për sasitë e ujërave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve si më poshtë:
 - $Q_{mes} = 194$ l/ditë/banor
 - $Q_{max} = 437$ l/ditë/banor

- Nëse është e mundur sistemi i largimit të ujrave të bardha dhe të zeza të jetë i ndarë, në të kundërt të ruhet sistemi miks.
- Të parashikohet rehabilitim i shtresave të rrugëve nga ndërhyrjet për ndërtimin e KUN, sipas shtresave ekzistuese duke i rikthyer në gjendjen fillestare.
- Për rrugët që do të trajtohen me shtresa betoni të parashikohet edhe përpunim sipërfaqësor për rritjen e aderencës së përdoruesve të rrugës por edhe të jetëgjatësisë së shtresës së betonit.
- Shkarkimi i banesave në pusetat e kontrollit do të bëhet nga vetë banorët.
- Materiali i tubacionit të brinjëzuar të kanalizimeve të jetë HDPE SN8.
- Materiali i tubacionit të dërgimit, by-pass etj të jetë PE100.
- Materiali i pusetave, gropave septike, atyre të dekantimit, stacioneve të pompimit, etj do të jetë beton i klases jo më të vogël se C25/30 me karakteristika të përmirësuara në funksion të klasave të ekspozicionit.
- Celiku i ndërtimit që do të përdoret duhet të jetë i vijaskuar me B450C-B500C.
- Të parashikohen stacionet e pompimit në mënyrë të tillë që rrjeti i kanalizimeve të lagjes “Baba Rexhepi” të derdhet në kolektorin e rrugës “Idriz Alimadhi” pranë degezimit të saj me rrugën “Peshkatari”.
- Të parashikohet pastrimi i kolektorit të ri 800mm të ndërtuar si pjesë e bulevardit të ri të qytetit.

6 – PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

- Koorografinë në shkallë 1:2500 ose 1:5000, në format A3.
- Planimetria e zones ku ndodhet objekti së bashku me rrjetin ekzistues të kanalizimeve, në shkallë 1:250 ose 1:500 ose 1:1000, në format A3.
- Skema hidraulike ekzistuese e kanalizimeve.
- Planimetritë e linjave primare, rrjetit sekondar, dhe rrjeteve grumbulluese terciare në shkallë 1:1000, në format A3, plan vendosja e pusetave, etj..
- Profilat gjatësore në shkallë H 1:1000; V 1:100 të shoqëruar me të dhënat hidraulike si diametri, DN.Ø mm, q=lit/sek, v= m/sek i=%, profilat terthore, detaje të nyjeve lidhese.
- Vijat piziometrike të linjave kryesore të dërgimit në puseta dhe impiant.
- Profila tërthorë/ tërthorë tip në shkallë 1:20 ose 1:50 ose 1:100 ose 1:150, ose 1:200, në format A3.
- Vepra tip, detaje tip të ndryshme në shkallë 1:10 ose 1:20 ose 1:50, në format A3.

- Skema hidraulike e KUZ të projektuar.
- Azhurnimet e rrjeteve inxhinierike ekzistuese, ujesjelles, kuz, elekrike, telefon, telekom, fibra optike, etj.
- Llogaritjet hidraulike.
- Projekti elektrik, tokëzimet, profilat gjatësore të linjës elektrike, dhe te sistemit scada detaje teknike etj. i hartuar nga ing. elektrik i licencuar (kur kemi sistem me ngritje mekanike)
- Përpilimi i Preventivit të Punimeve dhe Analizat Teknike të Cmimeve Njësi të bëhet duke u bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 216 date 13.04.2023, në format A4..
- Relacioni teknik për zgjedhjen e dhënë sipas detyrës së projektimit, i hartuar dhe firmosur nga projektuesi me licencën përkatëse së bashku me llogaritjet hidraulike (modelimi hidraulik), konstruktive, tubacioneve, stacione pompimi, elektropompa, puseta specifike, të shoqëruar me relacionin topografik. Raportet të jenë në format A4 dhe të ndara nga njëra tjetra.
- Specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi sipas zërave të punimeve të parashikuara në projekt preventiv në format A4.
- Çdo flete e projektit dhe preventivit të firmoset dhe vuloset nga projektuesi dhe Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime.

7 – VLERA PËR PROJEKTIM SIPAS VLERËS PARAPRAKE TË INVESTIMIT TË LLOGARITUR SIPAS VKM NR. 354, DATE 11.05.2016

Për llogaritjen e vlerës së projekteve është marrë për bazë VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, ku janë përfshirë fazat I, II, III, IV, V, VI, Seksioni I, Vepra Inxhinierike, grupi tarifor IV.

8 – FAZAT E PROJEKTIMIT DHE MËNYRA E DORËZIMIT

Fazat e projektimit:

Fazat e parashikuara dhe afatet orientuese për projektimin e objektit është 5 muaj:

- "Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës" për të gjithë objektet, 10 ditë nga lidhja e kontrates.
- Projekt-idea paraprake për të gjithë objektet, 1 muaj nga lidhja e kontrates.
- Projekt-idea përfundimtare për të gjithë objektet, 1 muaj mbas miratimit të projekt idese paraprake.
- Projekti i zbatimit dhe Preventivi përfundimtar për të gjithë objektet, 2 muaj mbas miratimit të projekt idese përfundimtare.
- Preventivi përfundimtar.
- "Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit" për të gjithë objektet, 20 ditë mbas miratimit të projekt zbatimit.

Të gjitha fazat do të kontrollohen dhe miratohen nga Drejtoria e Planifikimit të Investimeve, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Mënyra e dorëzimit:

- Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës, Projekt-idea paraprake, Projekt-idea përfundimtare në 1 (nje) kopje elektronike (në disk).
- Projekti i Zbatimit, Raporti Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivi Përfundimtar do të dorëzohen në Hard Copy në 2 (dy) kopje të firmosura në origjinal dhe në 2 (dy) kopje elektronike (në disk).
- Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit në 1 (nje) kopje elektronike (në disk).

9 – STANDARDET

- **Standarde në Projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislati në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën Shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit, nëse aplikohet.

- **Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

- **Rekomandime për projektuesin**

Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me zonën;

Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A;

Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.